



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 11

Datë: 20. 04. 2023. Ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 3. Aktivitetet e Zyrës**
 - Rekomandim për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq,
- 4. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së fletëvotimit për zgjedhjet për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan të datës 23 prill,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan të datës 23 prill,
- Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim/ndryshimeve të përbërjes së KVV-ve, për komunat Zubin Potok dhe Zveçan, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Zubin Potok, Zveçan të datës 23 prill 2023

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Rahovec

- **Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik**

- Njoftim nga Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari Radoniqi e hapi takimin dhe e paraqiti agjendën, ndërsa pastaj pa ndërhyrje, sugjerime dhe propozim të ndonjë pike të re, anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, tha se në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet që do të mbahen më 23 prill 2023 në Komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, bazuar në Planin Operacional, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka realizuar këto aktivitete deri me datë 19.04.2023. Në këtë aktivitet, duhet të theksojmë se Periudha e regjistrimit për votuesit me nevoja të veçanta – kategoria e parë e VPNV-ve, ka filluar me datën 26.03.2023. Kjo periudhë, ka përfunduar me datën 08.04.2023. Për këtë periudhë, në ueb

faqen e KQZ-së, janë publikuar të gjitha informatat e nevojshme, duke përfshirë formularin e aplikimit. Përgjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur asnjë aplikacion për regjistrim.

Periudha e regjistrimit për votuesit në Institucione ka filluar me datën 14.04.2023, dhe ka përfunduar me datë 19.04.2023. Me datën 12.04.2023, janë dërguar shkresat në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë, për pajisjen me emrat e personave që në ditën e zgjedhjeve gjenden në institucionet përkatëse shëndetësore, në Burgje dhe në Qendrat e Paraburgimit. Nga institucionet e lartë cekura nuk kemi pranuar asnjë të dhënë.

Periudha e votimit përmes postës ka filluar me datën 08.04.2023, dhe përfundon me datën 21.04.2023. Në këtë periudhë të regjistrimit, kemi pranuar vetëm një aplikacion për regjistrim, i cili pas vlerësimit të kriterëve të zotësisë juridike, kërkesa për regjistrim është aprovuar. Aplikacioni është dërguar nga shteti i Gjermanisë, dhe është aprovuar për komunën e Mitrovicës së Veriut. Pas miratimit të fletëvotimeve kemi dërguar fletëvotimin përmes e-mailit, për votuesin e regjistruar suksesshëm dhe deri sot nuk kemi pranuar ende zarfin kthyes me fletëvotim.

Sekretariati ka pranuar shabllonët (materialet e posaçme - alfabetit Brail-it) për realizimin e të drejtës së votës për personat e verbër dhe personat me të pamë të dobësuar. Ndarja e votuesve në vendvotime, deri në 2000 votues/vendvotim; Krijimi i skedarëve PDF të Listës përfundimtare të votuesve; Kontrolli i cilësisë së skedarëve PDF të Listës përfundimtare të votuesve;

Aktiviteti numër 56 “Shtypja, kontrollimi, paketimi dhe dërgimi i LPV-ve dhe LKV-ve në Depon e KQZ-së” ka filluar me datën 12.04.2023 dhe përfundon me datën 20.04.2023. Me datën 14.04.2023 janë dërguar CD-në tek Operatori Ekonomik e cila ka përmbajtur: Listat përfundimtare të votuesve për vendvotime, listat komunale të votuesve për qendra të votimit dhe listat e votuesve me kusht për vendvotimet me kusht. Shtypja ka filluar dhe përfundon me datë 20.04.2023, po të njëjtën ditë do të behët kontrollimi, paketimin dhe dërgimin i LPV-ve dhe LKV-ve në Depon e KQZ-së, më pastaj për tu dërguar në Depon e cila është caktuar në Mitrovicë të Jugut.

Z. Ahmetaj, në vijim të raportit të tij në mes të dy mbledhjeve, divizioni i trajnimit ne kuadër te planit Operacional për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune ne Mitrovicën e veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Laposaviq, është në vazhden e implementimit të aktivitetëve të trajnimit dhe në këtë aspekt, ai tha se 07.04.2023, është zhvilluar trajnimi i trajnerëve të Komisioneve Komunale te Zgjedhjeve për katër komunat. Pas kësaj, janë zhvilluar trajnimet lidhur me “Procedurat e votimit dhe numerimit”. Nërsa,

më datën 19.04.2023, ka filluar trajnimi i anëtarëve të KVV-ve të tri Komunave (Mitrovicë e veriut, Zvečan dhe Zubin potok), e lidhur po ashtu, me procedurat e votimit dhe numërimit.

Në përgjithësi, janë zhvilluar dy seanca me 50 pjesëmarrës. Ndërsa, më datën 20.04.2023, do të zhvillohet trajnimi i anëtarëve të KKZ nga komuna e Leposaviqit, dhe më 21.04.2023, është paraparë të zhvillohet trajnimi i anëtarëve të KKZ-ve për procedurat e pranimit-dorëzimit. Aktivitetet e Sekretariatit, janë zhvilluar edhe në drejtim të angazhimit të secilës komunë përkatëse në plotëimin dhe esojne/ndryshojnë dhe t'i kompeltojnë listat me anëtarë të KVV-te sipas Numrit të QV-ve dhe Vendvotimeve të miratuara, në 19 Qendra të Votimit e që ky afat ka përfunduar me datë 17 prill 2023.

Pas miratimit të lokacioneve të QV-ve, ka thënë në vazhdim z. Ahmetaj, është parashtruar kërkesë KEDS-it për sigurimin e llampave ndriquese. Më datë 14 prill 2023, është bërë publikimi i QV-ve në faqen zyrtare të Internetit të KQZ-se, dhe Vendimi i KQZ-se për miratimin e QV-ve i'u është përcjelle të gjitha institucioneve relevante. Dhe më 6 prill 2023, DKT ka kërkuar nga secila KKZ t'i përzgjedh stafet teknike të QV-ve, dhe më 19 prill 2023, secila KKZ ka dërguar listat e stafit në fjalë për ato QV që kanë mundur të përzgjedhen. Ndërsa, më 18 prill 2023, DKT ka përgatitur Planin Operacional të Veprimit për zgjedhjet e 23 prillit 2023, dhe se plani në fjalë do të zbatohet në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe MPB-në.

KQZ do të dërgojë ekipe për Monitorimin e Zgjedhjeve në katër Komunitat.

Në vazhdim krye shefi Ahmetaj, e ka njoftuar KQZ-në me atë se menjëherë pas aprovimit të qendrave dhe vendvotimeve, Sekretariati ka përgatitur planin e menaxhimit të kontratës dhe janë dërguar mostrat dhe sasia që duhet të shtypen. Sekretariati e ka mbikëqyrur procesin e shtypjes së Fletëvotimeve ku po printohen në Pejë. Me datë 17.04.2023 ka filluar shtypja e fletëvotimeve dhe broshurave dhe ka përfunduar me datë 19.04.2023. Pas shtypjes së fletëvotimeve ka filluar procesi i paketimit dhe përfundon me datë 20.04.2023 kur edhe mund të bëhet transportimi në deponë të KQZ-së.

Gjithashtu, sekretariati ka realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet e Prokurimit që janë planifikuar për zgjedhjet që do të mbahen më 23 prill 2023. Ndërsa, aktiviteti i prokurimit furnizim me ID Bexha për staf dhe vëzhgues nuk ka mundur të realizohet pasi që nuk ka aplikuar asnjë Operator Ekonomik edhe përkundër dy tentimeve. Në anën tjetër, aktivitetet e prokurimit janë planifikuar dhe do të shërbejnë për funksionalizimin e Qendrave të Votimit në katër komunitat, është në proces e sipër dhe pritet të realizohen me datë 20 dhe 21 prill 2023.

Lidhur me raportimet e policisë për fushatës zgjedhore, deri sot kur po kalon dita e 17-të e fushatës zgjedhore, nuk është bërë asnjë kërkesë për mbajtjen e tubimeve nga asnjë subjekt politik apo iniciativë qytetare, ka thënë z. Ahmeti.

Në vazhdim të raportit, është bërë e ditur se raporti vjetor i punës së KQZ për vitin 2022 për Kuvendin e Republikës së Kosovës që përmban edhe Raportin vjetor financiar i KQZ-së për vitin 2022 nga Sekretariati është draftuar dhe janë përfshirë komentet nga anëtarët e KQZ . Ky document, besojmë që do të shqyrtohet në KQZ, pas procesit të zgjedhjeve të 23 prillit 2023.

Lidhur me aktivitet e raportimi tre mujor për zbatimin e aktiviteteve të planit të punës dhe buxhetit për vitin 2022 dhe raportimet për vitin 2023, si dhe planit të punës së KQZ për vitin 2023, Sekretariati do të raportojë në KQZ për tremujorin e parë, dhe pasqyrat financiare për tre mujorin e parë. Ndërsa, ka raportuar kryeshefi, për planin strategjik i KQZ-së për vitin 2023-2026, nëngrupi punues e draftue hartimin e indikatorëve dhe është shqyrtuar nga koordinatorët nga KQZ. Edhe ky aktivitet, ka vlerësuar Ahmetaj, do të shqyrtohet në KQZ procesit të këtyre zgjedhjeve.

Pas përfundimit të këtij raporti, **Sami Kurteshi**, pyeti se sa është numri rreth numrit të personave të vendosur, dhe u tha se janë 50 persona, rreth ID-ve, ndërsa z. Ahmetaj tha se Sekretariati do ti prodhoj rreth 150 ID. Gjithashtu, ai tha se janë vonuar edhe procesverbale...

Ilir Gashi, pyeti rreth “kontejnerëve” dhe tha se, kush do ti dërgoj ata ? Kurse, z. **Selmanaj** tha se rreth periudhës së regjistrimit në institucione, cili është hapi konkret, a mund të realizohet kjo...?

Ahmetaj, tha se sekretariati sapo të identifikohen votuesit e komunave, që janë rreth 50, do ti krijojmë ekipet mobile, kurse kontejnerët – ky proces, ende nuk është përcaktuar se ku do të vendosen, por ky proces do të bëhet bashmë me MPB-në...

Arianit Elshani, pyeti se në çfarë faze është procesi i vendosjes së kandonierëve, kurse z. Ahmetaj tha se janë 26 kontinjerë ku do të votohet, dhe këtë do ta bëjmë komunë për komunë, do ti funksionalizojmë si duhet, është proces që merrë kohë deri të shtunën...

3.Aktivitetet e Zyrës

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP tha se aktiviteti për aplikim për vëzhgim të vëzhguesve të partive politike ka përfunduar më 17 prill, kurse për ojg dhe media vendore e ndërkombëtare, ka përfunduar më

18 prill. Në përgjithësi, kanë aplikuar 37 organizata vëzhguese: ato partiake, organizatat joqeveritare, mediat etj. Ka pasur organizata që nuk i kanë përmbushur kushtet e duhura për ti vëzhguar zgjedhjet, dhe ne i kemi refuzuar...

Rekomandim për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:

Në vazhdim të mbledhjes, KQZ akreditoi një nga një:

Lëvizja “Vetëvendosje!” me 40 vëzhgues, me 10 vota për, dhe 1 abstenim.

Partia Demokratike e Kosovës, me 32 vëzhgues, me 10 vota për, 1 abstenim.

Subjekti politik “Kosovski Serba”, me 3 vëzhgues, me 10 vota për 1 abstenim.

Ambasada britaneze me 2 vëzhgues, akreditohet me 10 vota për, 1 abstenim...

Në vazhdim, në pako u akredituan organizatat dhe mediat me 10 vota për, dhe 1 abstenim.

4.Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së fletëvotimit për zgjedhjet për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan të datës 23 prill:

Arianit Eshani, pasi që raportoi lidhur me këtë pikë, dhe shpjegoi materialet dhe dizajnet, tha se këshilli rekomandon për miratim...

Me vota unanime, miratoi dizajnin të vulës dhe të fletëvotimit për zgjedhjet për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan të datës 23 prill.

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të datës 23 prill.

Arianit Elshani, raportoi rreth planit operacional të shqyrtuar nga këshilli. Ai tha se, është shqyrtuar çdo aktivitet, lidhur me materialin, dhe mjetet e tjera, dhe gjithçka tjetër. E keni planin, dhe ne rekomadojmë miratimin.

Me vota unanime, u miratua plani operacional të veprimit.

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim/ndryshimeve të përbërjes së KVV-ve, për komunat Zubin Potok dhe Zveçan, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Zubin Potok, Zveçan të datës 23 prill 2023

Arianit Elshani, e njoftoi gjithashtu KQZ-në edhe për shqyrtimin nga këshilli të “plotësim – ndryshimeve” të përbërjeve të KVV-ve, dhe tha se ishte më i vështirë për ne ky proces dhe ka pasur vonesa, mirëpo sekretariati ia kemi arritur:

Në Leposaviq, janë 49 nominime për KVV, duke përfshirë 3 anëtarë rezervë.

Në Zubin Potok, janë janë 22 komisionarë, prej të cilëve 4 rezervë.

Në Zveçan, janë 28 komisionar prej të cilëve 3 janë rezervë

Në Mitrovicën e Veriut janë 63 komisionarë, prej të cilëve 24 janë rezervë.

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për dhe 1 abstenim miratuan vota përbërjet e KVV-ve.

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Rahovec:

Sami Hamiti, tha se këshilli ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe se Elma Hamza ka dhanë dorëheqje për shkak të një pozite të re që ka marrë, dhe ajo zëvendësohet nga Florida Bajraktari nga subjekti politik PDK.

Kërkesa është shqyrtuar sipas rregullit, dhe janë plotësuar kushtet dhe ne rekomandojmë që të bëhet ky zëvendësim.

Me vota unanime, u miratua ky zëvendësim.

Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik

Njoftim nga Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik

Fazli Stollaj tha se, produktet e Informimit Publik janë miratuar, janë realizuar dhe cdo gjë është në rregull, si dhe se për shkak të qendrave alternative, po ashtu informimi është duke u bërë në rregull...

3. Të ndryshme !